



Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga Ina Rama kryesuese, Mimoza Tasi relatores, Albana Shtylla, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo anëtarë, shpalli vendimin për çështjen nr. 7/2024, datë 16.02.2024, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 728, datë 28.12.2023.

Në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, vendosi:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 728, datë 28.12.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dorjan Tafilaj.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 18.07.2024, në Tiranë.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/)), NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME-SQ/](https://kpa.al/category/njoftime-sq/))

